



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.07.2024

Nr: 110

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2039 Prot., datë 18.07.2024, me:

Kërkues: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” (PS), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

“Partia Socialiste e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Edi Rama, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Data: 23.07.2024 Nr: 110
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 10.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me initiale “PS”, me kryetar z. Edi Rama, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Socialiste e Shqipërisë” me shkronja nistore “PS”, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Edi Rama, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Dhurata Isufaj, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Fatmir Muçaj dhe z. Enis Goxhi, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama, me shkronjat nistore “PS”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

